



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikës - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 82-25
Tarih/Dt.	22.05.2025

02 Nr. 82 / 25
Më: 22.05.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: “SHËRBIMET E FOTOKOPJIMIT, PRINTIMIT SHE SKANIMIT ME QIRA LOT 4 – RAJONI I PRIZRENIT- NIVELI LOKAL” e nënshkruar nga AQP me nr. të kontratës: 626-23-14341-2-1-1/C487-4, emërohet z. ERHAN TACI, ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. HIVZI MAZREK.

II

Pas pranimit të kontratës, ekipi për menaxhimin e kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin “Fillimi/mobilizimi i kontratës”. Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i Projektit do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;

- b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
- c. Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- *Drejtoria e Administratës,*
- *Drejtoria e Arsimit Kulturës Rinis dhe Sport,*
- *Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,*
- *Drejtoria e Shërbimeve Publike,*
- *Drejtoria e Planifikimit, Urbanizimit, Gjeodezi dhe Katastër,*
- *Drejtoria e Bujqësisë,*
- *Drejtoria e Financave,*
- *Drejtoria për Zhvillim Ekonomik,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

Abdullahi Krasniç
Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 81 -25
Me 19/05 -2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit

NENI 1

Z. Rujdi Mazrek Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë **Caktohet** personi përgjegjës nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit **“FURNIZIM ME MATERIAL PËR PËRGATITJEN FESTIVALIT XVI TË DOMATES”**

NENI 2

Personi përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

NENI 3

Obligohet- zyrtari përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. Dhe që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzojë specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. I/E caktuari/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 80/25
Me 16.05.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02/Nr.68/24 e datës 02.10.2024, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal Jug e datës 24.03.2025 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-68-24 i datës 02.10.2024 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financon projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 8,047.00 € sipas Raportin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug e datës 07.05.2025, pagesa për periudhën e muajit maj 2025, sipas numrit të zotimit 2025-93338, dhe 2025-24204.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
2. Palëve
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasnic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 79-25

Me datë: 16.05.25

Komuna e Mamushës

Në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03./-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të Rregullores (QRK) nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar neni 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës, datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës bie këtë vendim.

V E N D I M

Për ri-emërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në Pozitën e Drejtorit të SH.F.M.U "ANADOLU"

NENI I

Aprovohet- Kërkesa me numër të protokollit 02.Nr. 29-25 e datës 05.05.2025 e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Mamushës për ri-caktimin e z. Erol Morina si Ushtrues Detyre edhe për një afat prej 3 (tre) muajve nga data 19.05.2025 deri 19.08.2025.

NENI II

OBLIGOHET: Zyra e Personelit që brenda afatit ligjor të Shpall Konkurs të ri për rekrutimin e pozitës të drejtorit **Drejtorit të SH.F.M.U "ANADOLU"** në Komunën e Mamushës.

NENI III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në ditën e nënshkrimit

A R S Y E T I M

Drejtoria e Arsimit Rinisë, Kulturës dhe Sportit të Komunës së Mamushës, ka bërë Kërkesë për ri-emërimin e z. Erol Morina U.D Drejtor të Shkollës Fillore të mesme të ulët **ANADOLU**, i njëjti ka qenë i caktuar si U.D Drejtor i Shkollës Fillore me vendim andaj, ri-emërohet edhe për një afat prej 3 muajsh.

Ri-emërim i U.D drejtorit të shkollës është caktuar për shkak të përfundimit të kontratës, së drejtorit të shkollës përkatëse dhe dështimit në Konkursin e hapur. Andaj, në mungesë të pozitës së Drejtorit të Shkollës Fillore të mesme të ulët **ANADOLU** z. Erol Morinës i vazhdohet vendimi konform kërkesës së DKA-së për caktimin si U.D Drejtor i Shkollës deri në përfundim të procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit të Shkollës me Konkurs.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës të parashtruar nga Drejtoria e Arsimit pranë Komunës së Mamushës për ri-emërimin e Drejtorit të Shkollës fillore në Komunën e Mamushës e njëjta është aprovuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e U.D Drejtorit të Shkollës Fillore të mesme të ulët **ANADOLU** pranë Komunës së Mamushës është vazhduar konform Rregullore (QRK) nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve,

Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar.

Emërimi i përkohshëm i drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës bëhet nga subjektet që kanë përgjegjësi për emërimin me mandat të plotë të kandidatëve për këto pozita, Emërimi i përkohshëm i drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës bëhet kur: *Vendi i punës i drejtorit/eshës, zëvendësdrejtorit/eshës shpallet i lirë dhe emërimi i përkohshëm në raste të tilla bëhet deri në kryerjen e procedurave ligjore për përzgjedhjen e drejtorit/eshës, zëvendësdrejtorit/eshës të/së IEAA-AP të përcaktuara me këtë Rregullore.*

Duke marrë parasysh edhe se jemi në fillim të vitit shkollor U.D Drejtor Erol Morina është duke e udhëhequr institucionin shkollor, të njëjtit është vlerësuar se duhet që ti vazhdohet vendimi si U.D Drejtor i shkollës deri në përfundim të gjithë procedurave duke filluar nga organizimi i nxënësve, mësimdhënësve dhe procedurat e tjera me qëllim të mbarëvajtjes dhe fillimit të rregullit të vitit shkollor 2024/2025.

Andaj është vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DKA
- Z. Erol Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 78 -25

Me datë: 14.05.2025

Komuna e Mamushës

Në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr..03./-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 Udhëzim Administrativ (shëndetsi) nr. 04/2020 Kujdesi Paresor Shendetesor lidhur me nenin 26 dhe 27 të Ligji nr. 05/1 -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës, datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës bie këtë vendim.

V E N D I M

Për riemërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në pozitën e Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë

NENI I

APROVOHET: Kërkesa me numër protokolli 02.Nr.32-25, e datës 08.05.2025, e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës, që në pozitën e Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë të riemërohet z. Mirat Morina si Ushtrues Detyre për një afat prej gjashtë (6) muajsh, nga data 14.05.2025 deri më 14.11.2025.

NENI II

OBLIGOHET: Zyra e Personelit që, brenda afatit ligjor, të shpallë konkurs për rekrutimin e pozitës së Kryeinfermierit të QKMF-së në Komunën e Mamushës.

NENI III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës ka parashtruar kërkesë për riemërimin e z. Mirat Morinës si Ushtrues Detyre (U.D.) i Kryeinfermierit të QKMF-së në Mamushë. I njëjti ka qenë i caktuar më herët në këtë detyrë dhe, me kërkesën me nr. protokolli 02.Nr.32-25, të datës 08.05.2025, është kërkuar që t'i riemërohet edhe për një afat prej gjashtë (6) muajsh.

Riemërimi i Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë është bërë për shkak të mungesës së një kryeinfermieri të përhershëm në këtë institucion. Z. Mirat Morinës i vazhdohet vendimi konform kërkesës së DSHMS-së për caktimin si Kryeinfermier i QKMF-së në Mamushë deri në përfundimin e procedurave përzgjedhëse për Kryeinfermierin e rregullt.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pranë Komunës së Mamushës për riemërimin e Kryeinfermierit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, e njëjta është aprovuar, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e Kryeinfermierit të QKMF-së në Komunën e Mamushës është vazhduar konform Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Duke marrë parasysh rolin dhe funksionimin e QKMF-së, si dhe rolin e Kryeinfermierit në këtë institucion shëndetësor parësor, është vlerësuar se të njëjtit duhet t'i vazhdohet vendimi si Kryeinfermier i QKMF-së në Mamushë deri në përfundimin e të gjitha procedurave të konkursit të rregullt dhe publik.

Andaj është vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DSHMS
- Z. Mirat Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 77 -25

Me datë: 14.05.2025

Komuna e Mamushës

Në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03./-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 Udhëzim Administrativ (shëndetsi) nr. 04/2020 Kujdesi Paresor Shendetesor, lidhur me nenin 26 dhe 27 të Ligji nr. 05/1 -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës, datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës bie këtë vendim.

V E N D I M

Për riemërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së Mamushë

NENI I

APROVOHET: Kërkesa me numër protokolli 02.Nr.32-25, e datës 08.05.2025, e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës, që në pozitën e Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të riemërohet z. Ramadan Mazreku si Ushtrues Detyre edhe për një afat prej gjashtë (6) muajsh, nga data 14.05.2025 deri më 14.11.2025.

NENI II

OBLIGOHET: Zyra e Personelit që brenda afatit ligjor, të shpallë konkurs për rekrutimin e pozitës së Drejtorit të QKMF-së në Komunën e Mamushës.

NENI III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Mamushës ka parashtruar kërkesë për riemërimin e z. Ramadan Mazreku si Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së. I njëjti ka qenë i caktuar më parë në këtë pozitë me vendim përkatës, dhe me kërkesën me numër protokolli 02.Nr.32-25, të datës 08.05.2025, është kërkuar që të riemërohet për një afat prej gjashtë (6) muajsh.

Riemërimi i z. Ramadan Mazreku si U.D. Drejtor i QKMF-së është kërkuar për shkak të dështimit të konkursit të hapur me nr. RN00017502. Në mungesë të një drejtori të rregullt të QKMF-së, atij i vazhdohet vendimi, në përputhje me kërkesën e DSHMS-së, për të ushtruar detyrën e drejtorit deri në përfundimin e procedurave përzgjedhëse për këtë pozitë.

Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pranë Komunës së Mamushës për riemërimin e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, e njëjta është aprovuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e z. Ramadan Mazreku si U.D. Drejtor i QKMF-së është vazhduar në përputhje me Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Duke marrë parasysh rolin dhe funksionimin e QKMF-së, si dhe faktin që z. Ramadan Mazreku është duke e udhëhequr me përgjegjësi institucionin parësor shëndetësor, është vlerësuar se duhet të vazhdojë ushtrimin e detyrës së Drejtorit të QKMF-së deri në përfundimin e të gjitha procedurave të konkursit të rregullt dhe publik.

Andaj, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DSHMS
- Z. Ramadan Mazreku
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamusa – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 76/25
Me 12.05.2025
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/l-212 i Punës, Kërkesën me nr. 08.Nr.01/25 të datës 06.01.2025, Raportin nga DSHMC me nr. 02.Nr.01-25 e datës 08.01.2025, Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin në Listë të Pagave dhe pagesën Retroaktive

Neni 1

Aprovohet kërkesa me numër protokolli 08.Nr.01/25, e datës 06.01.2025, e znj. Klodeta Kabashi Shahini për ndryshimin e koeficientit pas përfundimit të shkollimit specialistik në lëmin e Biokimisë Klinike, dhe që koeficienti të ndryshohet në bazë të Ligjit për Paga, shtojca nr. 9 – Nëpunësi publik i sistemit shëndetësor, pika 11, me titull të pozitës Specialiste.

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurën ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Kontratës së Punës me numër të protokollit 02.Nr./76-25 e datës 08.05.2025 dhe atë me koeficient 12.5 Klasa H8 bllokun koduese 10/626/73850/0721.

Neni 3

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurën të përgatit formularin edhe për pagesën retroaktive nga data 01.04.2025 deri me datën 30.04.2025 në shumën e përgjithshme prej 313.39€.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

znj. Klodeta Kabashi Shahini në bazë të kontratës paraprake ka qenë Mjeke e përgjithshme pranë, QKMF në Mamushë, më pas bazuar në vendimi e Ministrisë së Shëndetësisë iu është lejuar specializimi në lëmin e Biokimi Klinike.

E njëjta pas përfundimit të shkollimit specialistik iu është drejtuar me kërkesë me numër të protokollit 08.Nr.01/25 të datës 06.01.2025 për ndryshim të koeficientit pas përfundimit të shkollimit specialistik.

Kërkesa ka bazë juridike për ndryshim të koeficientit bazuar në Licencën të lëshuar nga Komisioni për Licencim me të cilën ka marrë titullin Mjeke Specialit Biokimisë Klinike.

Ndërsa për të lartcekurën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të bëj pagesën në mënyrë Retroaktive nga data 01.04.2025 deri me datën 30.04.2025 në shumën e përgjithshme prej 313.39€.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Me këtë njoftohen

- DSHMS
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 25 /25
Me 07.05.2025
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/1-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/1-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

z. Nahit Kruezi me titull të pozitës Teknik dhe Mbështetës, transferohet në bllokun koduese 10/626/73850/0721 në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Vendimit 02.Nr./56-25 e datës 01.04.2025.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z. Nahit Kruezi në bazë të konkursit me titull të pozitës Teknik dhe Mbështetës është përzgjedhur Teknik dhe Mbështetës në Sh.F.M.U “ANADOLU” dhe ka nënshkruar kontratën e punës me datën 23.05.2023.

Për shkak të nevojave të QKMF-ës, për pozitën në QKMF, me pëlqimin e të dyja palëve, i njëjti me vendim 02.Nr.56-25 të datës 01.04.2025 transferohet në mënyrë të përhershme në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë në Pozitën Teknik dhe Mbështetës/ Vozitës.

Me këtë njoftohen

- DSHMS
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 74 -25
Me 06/05 .2025
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e ekip përgjegjës nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike

NENI 1

Caktohet- Ekipet përgjegjës nga të gjitha Drejtoritë Komunale/Njësitë Kërkuese për hartimin e specifikimeve për projektin *“Furnizim me Dru dhe Pelet për Ngrohje”*.

NENI 2

Personat përgjegjës për hartimin e për hartimin e specifikimeve teknike janë Drejtor të Drejtorive Komunale.
Njësitë Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike të cekur në Nenin 1 të këtij vendimi do të ketë këtë përbërjeje:

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

❖ Z. Yahya Sala- Drejtor

Drejtoria e Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sporti

❖ Z.Turker Mazreku - Drejtor

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

❖ Z . Burak Morina

NENI 3

Personat e cekura në nënin 2 të këtij vendimi janë të ndarë nga të gjitha drejtoritë komunale si njësi kërkuese për projektin *“Furnizim me Dru dhe Pelet për Ngrohje”*. me qëllim të përshkrimit të saktë të specifikave teknike në bazë të nevojave për Objektin e Administratës dhe Institucioneve vartëse të Komunës së Mamushës, ekipet janë përgjegjës që për secilin drejtori/ sektor të bëjnë specifikat teknike në baz të nevojës të Njesisë Kërkuese në bazë të projektit *Furnizim me Dru dhe Pelet për Ngrohje”*.

NENI 4

Obligohet- Personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike, që se bashku me Specifikimet teknike duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP, ku deklarohet që specifikimet teknike janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik dhe që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

NENI 5

Ekipi përgjegjës duhet të dorëzojë specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit për projektin e cekur në nenin 1 të këtij vendimi.

NENI 6

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/at.
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

MAMUŠA BELEDIYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

Zyra e Kryetarit

02 Nr. 73/25

Me 06.05 2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008 nenit 44 dhe 45, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës NR.21/18 shtator 2023 , lidhur me nenin 12,paragragfi 1,2 nënparagrafi 2.3,pragrafi 3 nënparagrafi 3.1. 3.2 dhe 3.3 të Rregullores (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën E Pranimi të Nëpunësve të Shërbimin Publik në Sektorin e Shëndetësisë nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

VENDIM

Komisioni i pranimi për pozitat profesionale

I. Formohet: Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë

II. Komisioni i Pranimi në pajtim me neni I të këtij neni përbëhet nga:

- Znj. Sihana Uka Kryesuese Menaxhere e personelit
- Z.Mehmet Morina – anëtare
- Znj.Seylan Alaybeg-anëtare
- Z. Ramadan Mazreku - anëtar
- Z.Emrah Morina– anëtar

III. Komisioni i pranimi si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës

IV. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën E Pranimi Në Shërbimin Publik në Sektorin e Shëndetësisë.

Kryetar i Komunës së Mamushës
Abdullah KRASNIC





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02.Nr. 72/2025

Me_06.05.2025 Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neni 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushës ,të dates 01.12.2008 Kryetarui I Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesë e Kujdestarisë QKMF - Mamushë

Neni . 1

Aprovohet kërkesa e Qendrës së Mjeksisë Familjare-Mamushë për pagesën e kujdestarisë, per muajin **Pril/2025**,

Neni . 2

Mjetet që lejohen për pagesë janë te dedikuara për periudhen **01.04.2025 deri 30.04.2025**, ne shumën prej **2.889,84 €** nga programi **Sherbimet e Shëndetësisë Primare**, kodi **73850** nga kategoria paga dhe mëditje.

Neni . 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtëvendim të njoftohet :

1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirqenje Sociale
2. Departamenti i pagave-Thesar
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniq





02 Nr. 74/25
Me 05.05.2025
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë për ndërtesat në kuadër të Komunës së Mamushës për vitin 2025

Neni 1

Konform Marrëveshjeve për Shërbime të Energjisë në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencën e Energjisë(FKEE) dhe Komunës së Mamushës datë 16.03.2022 dhe Aneks Marrëveshjeve datë 19.04.2023 dhe sipas njoftimit datë 14.04.2025 nga FKEE për planin e pagasave të vitit 2025, për ndërtesën e SHFMU Anadolu-Mamushë, Gjimnazin Ataturk-Mamushë, Ndërtesën e Kuvendit Komunal në Mamushë dhe Ndërtesën Shërbimet Komunale në Mamushë.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas shumës 6,488.00€ dhe të dhënave në vijim:

Nr.	Përfituesi	ID	Xhirollogaria	Shuma €
1.	FKEE	602200066	1708020600000153	6,488.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit dhe për zbatimin e vendimit është përgjegjëse Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Fondi i Kosovës për Eficiencën e Energjisë-(FKEE)
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç



Rrjedha.

Muhamet Morina tash pronar i ngastrës kadastrale sipas kontratës së shitblerjes të vërtetuar tek noteri Besim Luli me numër Ref 58/2022, parcelë të cilin e ka blerë nga Gafur Mazrek nga Mamusha si shitësi parcelën e ka trashëguar nga me të cilin edhe e ka regjistruar në Librat Kadastral.

Rruga për të cilin pala pretendon se të kompensohet apo të merret vendimi nga Komuna e Mamuhës për largimin nga ngastra kadastrale, nuk është ndërtuar nga Komuna e Mamuhës, fillimisht rruga si e tillë vetëm se ka ekzistuar edhe para luftës së Kosovës në vitin 1999, ku pas hyrjes së forcave të NATO-s Ushtria Turke e vendosur në territorin e Komunës së Mamushës dhe Prizrenit këtë rrugë e ka ndërtuar vetë për të pasur lëvizje dhe Kontrolle në atë pjesë, më tutje vlen të theksohet se në kohën për të cilin vetëm se është ndërtuar kjo rrugë Komuna e Mamushës nuk ka ekzistuar fare pasi që si Komunë është themeluar në vitin 2006 si pilot njësi ku më pas gjatë vitit 2008 me kompetenca të plota të Vetëqeverisjes Lokale.

Pala kërkuese në kohën vetëm se kur e ka blerë këtë parcelë nga ish pronari apo shitësi Gafur Mazrek rruga vetëm se ka qenë aty pasi që edhe shitësi dhe paraardhësit e shitësit gjatë vitit 1999-2000 kanë lejuar që ajo parcelë të shfrytëzohet si rrugë.

Vlerësimi përfundimtar

Nëse bazohemi në Ligji nr. 04/I-077 për marrëdhëniet e detyrimeve nën kreu 2 përgjegjësia për të metat materiale gjegjësisht në nenet si në vijim *Neni 461 Të metat materiale për të cilat shitësi përgjigjet 1. Shitësi përgjigjet për të metat materiale të sendit të cilat sendi i ka pasur në çastin e kalimit të rrezikut në blerësin, pavarësisht se shitësi ishte në dijeni apo jo për të metat e sendit. 2. Shitësi përgjigjet edhe për ato të meta materiale të cilat shfaqen pas kalimit të rrezikut në blerësin, në qoftë se janë pasojë e shkakut i cili ka ekzistuar më parë. 3. E meta materiale e parëndësishme nuk merret parasysh.*

Neni 463 Të metat, për të cilat shitësi nuk përgjigjet 1. Shitësi nuk përgjigjet për të metat e specifikuar në paragrafët 1. dhe 3. nga neni paraprak në qoftë se blerësi në momentin e lidhjes së kontratës ishte në dijeni për këto të meta, ose ato nuk kanë mund të jenë të panjohura për atë. 2. Konsiderohet se nuk kanë mund të jenë të panjohura për blerësin ato të meta të cilat një person i kujdesshëm, me dituri dhe përvojë mesatare të personit të mjeshtërisë dhe të profesionit të njëjtë sikur të blerësit do të mund t'i vërente lehtë gjatë shikimit të rëndomtë të sendit. 3. Megjithatë, shitësi përgjigjet edhe për të metat të cilat blerësi ka mundur t'i vërente lehtë, në qoftë se shitësi ka deklaruar se sendi nuk ka kurrfarë të metash apo se sendi ka cilësi apo karakteristika të caktuara.

Andaj, nga kjo del themelësia se blerësi është dashur të dijë se vendi apo parcela të cilin e ka blerë nga shitësi ka të meta materiale, apo është dashur që të njoftohet se sendi ka të meta materiale të shkaktuara para blerjes së parcelës në fjalë.

Kërkesa e Mehmet Morinës është e *pabazuar* pasi që i njëjti me asnjë provë të nuk ka mundur që vërteton faktin se gjatë kohës për deri sa ai ka qenë pronar i kësaj prone, e që në pronën e tij është ndërtuar rruga për të cilin pala pretendon kompensimin apo që të merret vendim për largimin e rrugës nga parcela e tij.

Në bazë të provave në të cilin mund që ti sigurojmë ne si institucion e vërtetojmë faktin se i njëjti gjatë kohës së blerjes së parcelës në fjalë rruga vetëm se ka ekzistuar aty, dhe se i njëjti në bazë të kontratës së shitblerjes ka pranuar blerjen e parcelës ashtu siç është gjendja aktuale e kësaj prone.

Andaj është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh në Komisionin e Ankesave në Komunën e Mamushës.

Kryetari i Komunës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 69 / 2025
Datë : 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, Ligji nr. 08/I-197 Për Zyrtarët Publik, lidhur me Neni 13 dhe shtojca nr. 10.7. – Komunat ligji nr. 08/I-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nenet 21, 22, neni 46, 47, 48 lidhur me nenin të ligji nr. 05/I -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 20 / 21 qershor 2016, Prishtinë).

V E N D I M

Refuzohet: Kërkesa e Erhan Tac me numër të protokollit 02.Nr.24/25 e datës 18.04.2025 të parashtruar në Zyren e Zyrtarit Kryesor Administrativ Mamushë me të cilin kërkon që të merret aktvendim me të cilin aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të bëhet Kompensimi i diferencës së pagës në mënyrë retroaktive bazuar në koeficientin për ekspert si dhe vendosja e Koeficientit sipas ligjit nr. 08/L-196, për pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) nr.22/2024 për ekspert.

Pretendimet e palës kërkuese.

E autorizuar e palës kërkuese përmes shkresës të dërguar në zyrën e Zyrtarit Kryesor Administrativ bazuar në ligji nr. 08/I-196 Për Pagat në Sektorin Publik në nenin 44 paragrafi 1.14 pika 1.14.4 të shtojcës 14.4 dhe Rregulloren (QRK) nr.22/2024 për ekspert.

Në bazë të Rregullores (QRK) nr. 22/2024 për Ekspertët, neni 3 përcakton se: Kriteret për caktimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike. Sistemet do të vlerësohen si sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike nëse plotësojnë të paktën një prej kriterëve të përcaktuara në përkufizimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196, shtojca 14.4 dhe në rregulloren (QRK) nr. 22/2024 për Ekspertët, parashtruesi i kërkesës i përmbush kushtet ligjore për këtë koeficient pasi që menaxhon dhe administron (kanë rol Administrator) me sistemet shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore dhe/ose komunikimeve elektronike.

Andaj, marrë parasysh se kushti është vetëm një kriter, e parashtruesi i kërkesës plotëson më shumë se një kriter, ne kërkojmë nga ju që të njëjtit t'i bëhet kompensimi i diferencës në koeficient prej datës 05.01.2023, dhe ti vendoset koeficienti bazuar në (QRK) nr.22/2024 për ekspertët dhe Komunat ligji nr. 08/I-196 Për Pagat në Sektorin Publik.

Vlerësimi nga ana e Institucionit

Pas analizimit të kërkesës me numër të protokollit 02.Nr.24-25 e datës 18.04.2025 të z. Erhan Taç të cilin e përfaqëson AV. Liridonë Krasniqi, kërkesa është e pa bazuar pasi që të njëjtin nuk kanë dhënë asnjë provë të vetme me të cilin e bëjnë të besueshëm kërkesën e parashtruar pranë këtij institucioni dhe se e njëjta është e **pa bazuar**.

Për sa i përket caktimit të koeficionenti e njëjta nuk është bërë nga Komunitat në Kosovë por që para hyrjes në fuqi të Ligjit për pagat në Sektorin Publik, komisioni i caktuar në DMPZ Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, kanë parashtruar kërkesë në të gjitha komunitat për pajisjen me kontrata të punës, aktemërimë, konkurse eventuale andaj, duke u bazuar në këto të dhëna është caktuar koeficienti, nëse marrim dhe e analizojmë konkursin në të cilin ka aplikuar z. Erhan Tac me nr.tëReferencësRN00010014 KodiRPC0003723 të dates 26.09.2022 Zyrtar i Teknologjisë Informative Profesional 2 me koeficionet të atërshtëm 7 dhe akt emërimit të punës DMZP të njëjtin e ka vendosur në të njëjtin gradë duke mos e kualifikuar si ekspert siç pretendohet në kërkesën e parashtruar.

Komuna nuk ka kompetencë që bënë këtë pasi që me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës caktohet Komisioni vlerësim të kërkesave të parashtruara nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit në kuadër të cilit funksionojnë pozitë përcaktuara në shtojcën 14.4. të ligjit, parashtron kërkesë për përcaktim të zyrtarëve si ekspertë në përputhje me këtë shtojcë. Kërkesa parashtrohet tek Komisioni për Ekspertët i themeluar me vendim nga Qeveria, pas propozimit nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike. Komisioni për Ekspertët sipas paragrafit 2 të këtij neni, përbëhet nga tre anëtarë si në vijim: dy (2) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike; një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Financa; Anëtarët e Komisionit për Ekspertët emërohen me mandat tre (3) vjeçar. 5. Punën e Komisionit për Ekspertët e udhëheq Kryesuesi i Komisionit për Ekspertët.

Komisioni i caktuar me vendimin nr. 07/132, komisionin për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike.

Komisioni i caktuar nga Qeveria Republikës së Kosovës bazuar dhe në rregulloren për ekspert ka bërë vlerësimin në cilin ka bërë një raport me të cilin ka përpiluar një listë të sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike dhe ekspertëve të kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të ligjit nr. 08/l-196 për pagat në sektorin publik, në të cilin nuk janë të përfshirë edhe zyrtarët e teknologjisë informative në Komuna, këtë pretendim e ka bërë bazuar në atë se nuk posedojnë sisteme me rëndësi strategjike mirëpo për shkak të rëndësisë së vet institucionit, duhet të gjendet një mënyrë për të i kategorizuar edhe zyrtarët e këtyre institucioneve sipas shtojcës 14.4.

Si përfundim vlen të theksohet se Komuna e Mamushës nuk ka legjitimitet pasiv që të jetë palë në këtë procedurë pasi që nuk është organ i cili mund të cakton një koeficionet apo kategori të caktuar në bazë të ligjit të pagave pas mbarimit të procedurave të konkursit, pra siç është thekuar edhe më lartë i njëjti është në kategori profesionale dhe si e tillë nuk mund të bëhet në kategorinë e ekspertit vetëm me një vendim apo ndryshim nga ana e institucionit ku punon, ndryshimet e tilla mund të bëhen vetëm nga Komisioni i caktuar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjegjësisht nga DMPZ, i cili bënë ndryshime të kategorisë në bazë ekuivalencës së punës së kryer bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara në bazë të Konkursit dhe Kontratës së Punës.

Andaj duke u bazuar në të lartë cekurat kërkesa është e pa bazuar në asnjë dispozitë ligjore, dhe nuk gjen mbështetje.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh në Komisionin e Ankesave në Komunën e Mamushës.

Kryetari i Komunës
Abdülhadi Krasniç

